


KOSTANDIN LELI

854-93-32

L 44



përsëri  
me të

691.983-93-32

L 44

S

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

KOSTANDIN LELI

# PËRSËRI ME NE

— T r e g i m e —

1982  
~~54103~~  
BIBLIOTEKA E SHITËRISË  
DURRESË

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## KËMBËNGULJE ELEKTRICISTËSH

Ishim gjithësej 20 vetë. Bashkë me ne ndodhej edhe mësuesi i fizikës. Do të shkonim në Spiten, rreth tri orë larg fshatit tonë. Kishim vendosur të qëndronim aty dy javë për të ndihmuar në instalimet e brendshme të rrjetit elektrik.

Kryetari i këshillit u gëzua kur na pa.

— S'ma priste mendja të vijshit kaq shpejt!

— Është më mirë kur nisesh me fresk.

— Ashtu është, ashtu... e po... ç't'ju them tjetër, veç t'ju uroj punë të mbarë. Këtu do të kaloni shumë mirë. Ju jeni ndarë në katër brigada, apo jo? Ashtu... I kemi caktuar brigadat sipas shtëpive. Pa, he, ... t'i shoh një herë brigadierët.

Dolëm unë, Mrika, Kola dhe Gjergji.



Kryetari mblodhi një herë supet, bashkoi fort buzët, lëvizi kokën majtas e djathtas, pastaj buzëqeshi.

— Shih, shih sa bukur e keni mendue! Dy vajza brigadiere.

— E kanë meritue, bre Salë, — foli mësuetsi si duke qeshur.

— E, e, dihet, se kot s'i caktojshit.

Brigada e Mrikës shkoi në një shtëpi aty afër. Dy të rinj, që thirri kryetari pak më vonë, shoqëruan brigadën e Kolës dhe të Gjergjit për në lagjen e sipërme, ndërsa unë me brigadën time dhe me kryetarin shkuam te shtëpia pranë çezmes kryesore të fshatit.

Aty, nga lesa deri te shkallët, rruga ishte shtruar me kalldrëm. Në të dy anët e kalldrëmit ishin mbjellë plot lule. Nën strehë ndodhej një kafaz pëllumbash dhe anës murit përsëri një lulishte e vogël e rrethuar me parmakë. Gjithçka tregonte punën e një njeriu të kujdesshëm.

Te shkallët doli një grua plakë.

— Mirë se të gjejmë, o nanë Prenda!

— Mirë se ke ardhë, Salë, me miq bashkë.

Po urdhëroni brenda, hajdeni fëmijë, hyni. . .

— E di si asht puna, nanë Prenda, — e mori fjalën kryetari. — Këta kanë ardhë nga Mantia me vu dritat.

— Fëmijët me ba ket punë, or Salë! — hapi sytë nanë Prenda, duke shikuar me habi herë nga ne e herë nga kryetari i këshillit.

— Kanë me i goditë aq bukur, sa ke me u çuditë.

— Ty t'besoj, mor pooo. . . s'ashtë as Gjeta këtu. . .

Diçka si drojtje, si hutim lexohej në sytë e nanë Prendës.

— Kena bisedue në mbledhje të popullit për ket punë oj nanë, unë e kam pa vetë punën e tyne, pastaj si Gjeta, si ti njëlloj asht. . .

— Jo, mor Salë, po ai asht. . .

— Kreu i shtëpisë, a? — foli me zë të lartë e duke qeshur kryetari. As ne s'e përmbajtëm dot gazin. — Ah, moj nanë Prenda, besa mos na korit para këtyne miqve, kanë me mendu se jena hala me të vjetrën.

— Jo, mor, po ai i din ma mirë kto punë, poooo. . . fëmijët tash janë miq të shtëpisë, të futen një herë brendë.

Ne hymë brenda. Kryetari na uroi punë të mbarë e u largua.

Vërtet hymë brenda, po të them të drejtën, qëndronim pak si të hutuar e s'po merrnim guxim të uleshim. Shikonim njëri-tjetrin në sy, sikur donim t'i thoshim: «Hë pra, ç'të bëjmë»?



— Uluni, uluni! — dëgjuam zërin e nanë  
Prendës e cila sapo erdhi nga dhoma tjetër.

U ulëm si me përtesë. As vetë nuk e kup-  
tonim pse e ndjenim veten të drojtur dhe të  
hutuar. Rrudhi pak buzët e mblodhi supet nanë  
Prenda kur mori vesh se unë isha brigadiere.  
Mosbesimi e habia e pushtuan plakën po, me-  
gjithatë, nuk nxori asnjë fjalë nga goja.

Pas pak te dera u duk lalë Gjeta. Ne u  
ngritëm menjëherë në këmbë. Ai na takoi të  
gjithëve me përzemërsi dhe u ul. Si më rrihte  
zemra!

«Po sikur... ky...?!»

— Më thanë se më kanë ardhë miq në  
shtëpi, mora leje te brigadieri dhe erdha.

— Ne kemi ardhur për të vendosur fijet  
e telit për dritën elektrike, lalë Gjeta, — i tha-  
shë unë dhe i ngula thellë vështrimin, duke pri-  
tur me padurim fjalën e tij.

— Punë e mirë fort kjo jueja, pooo, unë  
kam një mikun tim në qytet e ai më ka dhanë  
fjalën me m'i rregullue.

Kjo ishte e papritur. Të na thoshte «Ju  
s'e bëni dot, dija unë si t'i përgjigjesha, po tani  
puna na doli ndryshe.

«Kjo s'është e vërtetë», — thashë me vete  
dhe hodha shikimin nga shokët. Ata rrinin të  
heshtur.

— Miku mund të vijë si mik, lalë Gjeta, ndërsa këtë punë po e bëjmë ne.

— Unë s'kam as tel tamam, s'besoj se mjafton as për një dhomë; dje ja dhashë një fshatarit këtu, se ndërtoi shtëpi të re.

Mund të ishin të vërteta fjalët e tij, po mund edhe të mos ishin, sidoqoftë ne duhet të ngulnim këmbë. Ai s'kish besim te ne, e sidomos te unë, që isha brigadiere. E vija re shpesh se, kur fliste, më tepër shikonte nga djemtë se nga unë. Më dukej sikur donte të thoshte: «Po ju, ore, katër djem, a s'ju vjen turp që keni brigadiere një vajzë?»

— Ne po punojmë vetëm në një dhomë derisa të gjesh telin, — i tha Prenga.

— Jo, mor, po... pastaj ju jeni fëmijë e mue më vjen keq me ju lodhë.

— Veç kjo punë që s'na lodh, o lalë Gjeta.

Plaku s'tërhiqej lehtë, po edhe ne ca më pak. Ai bënte sikur kërkonte diçka në xhepin e xhaketës. Diç bluante në mendje lalë Gjeta. Ndofta mundohej të gjente një shkak që ne të mos punonim në shtëpinë e tij.

— Po mirë, bre, ne po bajmë një gja tjetër: sa të rregulloj unë fijet e telit, ju punoni në një shtëpi tjetër.

— Çka thue, or burrë, kjo don me thanë «ikni prej shtëpie!» — foli papritur e shoqja.



— Mos, moj grue, se më ke vra me ato fjalë, ne s'e kena zakon me...

— Po pse s'e kena zakon, prandaj s'duhej me folë ashtu, — foli nanë Prenda, këtë radhë si duke qeshur.

Qeshëm edhe ne, qeshi edhe lalë Gjeta.

— Mirë, mirë, atëhere po e fillojmë nga ajo dhoma e vogël, oj plakë.

— Po pse, te kjo këtu nuk bën, o lalë Gjeta? — ja ktheu Prenga.

— Kjo asht e madhe dhe unë s'kam aq tel, se edhe këtu po e fillojshim.

Ardhja e mësuesit atë çast na gëzoi së tepërmi. Plaku sa dëgjoi zërin e tij, brofi menjëherë në këmbë e doli te porta.

— Po ata janë fëmijë, bre, — dëgjuam t'i thoshte ai mësuesit ngadalë kur po ngjitnin shkallët.

— Do të kënaqesh, o Gjetë, kur të mbarojnë, hiç mos u mërzit!

— Ty, po, të besoj, më qenë dhe ti, ma mirë do të ishte.

— Si unë, si fëmijët njëlloj është. Më mirë se fjalëve, t'i besosh punës, do ta shikosh vetë. Erdha sa të të takoj e do shkoj prapë.

— A, jo, tash s'ke me ikë. Si thoni, fëmijë, a nuk asht turp me e lanë mësuesin me ikë? — na u drejtua neve sapo hyri brenda.



— Si ta ketë punën, — ja ktheu Prenga.

Lalë Gjeta lëvizi kokën majtas e djathtas e buzëqeshi paksa, sikur donte të thoshte: «Të lumtë, ma hodhe».

Aty nga dreka ne filluam nga puna. Pleqtë rrinin në këmbë. Mësuesi nuk fliste fare. Shpesh ai dilte jashtë. Lalë Gjetës s'i vinte mirë që ai dilte, e shpesh sikur matej t'i thoshte të qëndronte aty, po prapë kthente mendje. Lart, në mur, afër tavanit, hapëm një vrimë me daltë e çekiç për të vendosur kutinë «Bergman». Mësuesi buzëqeshi, sikur donte të thoshte: «Mirë, shumë mirë».

Ata shikonin mësuesin e, meqë e kuptonin se ai ishte i kënaqur, s'flisnin fare; megjithatë, nuk u erdhi mirë kur vunë re se po matej të largohej.

— Mos harro me ardhë në mbramje! — i tha lalë Gjeta.

Mësuesi buzëqeshi dhe doli nga dera.

Kur hapëm kanalin për te vendi i çelësit, nanë Prenda foli si me turp:

— Oh, po kështu muri u prish fare!

— Mos ki frikë, unë jua kam pa punën në fshatin e tyne, — u përgjegj në vendin tonë një fshatar që sapo kish ardhur. — Pashë dhe shokët e tyne te shtëpia e Dodës.

— Këtu do të vendoset teli me tubin, o

